# STATUT

## NENI 1

Formohet shoqerija tregetare "GJERGJI" SH.P.K. "Ortak i vetem" i themeluesit PJETER PRELA i biri i Gjerjgit dhe Dieles, dtl.1958 banues ne Lezhe Lagja Besëlidhja.

## VEND QENDRIMI

## NENI 2

Vend qendrimi i shoqerise eshte le gajen Beselidhja Lezhe

Shoqerija mund te hape dhe vend qendrime te dyta, operative, filiale, përfaqesi dhe agjensi ne te gjithe teritorin e Republikes

## KOHE ZGJATJA

## NENI 3

Shoqerija "GJERGJI" SH.P.K. "Ortak i vetem" ka nje kohe zgjatje te veprimtaris se saje ekonomike mbi 10 vjet

## OBJEKTI I VEPRIMTARISE

## NENI 4

Objekti i veprimtaris se shoqzrise do te jete ne fushen:

Ndertime civile deri 5 kate, pu ime dheu, muratur, beton, beton arme, e zakoneshme, pu ime shembjesh, ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore e kompletime me instalimet e nevojeshme për to, si dhe punime restaurimi

Tregetim te materjaleve te para, materjale dhe paisje, makineri te llojeve te ndryshme përfshi dhe mjetet e transportit si dhe pjese kembimi për te me shumice e pakice, import eksport.

## KAPITALI I SHOQERISE

## NENI 5

Kapitali fillestar i shoqerise eshte 100.000 leke dhe i përket ortakut te vetem. Ky kapital eshte i depozituar ne banke.

## DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

## NENI 6

Shoqerija "GJERGJI" deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te rregullave qe përmban ky statut i saje dhe ato te legjislacionit Shqiptar ne fuqi. Ajo eshte krijuar dhe do te veproje ne zbatim e ne përputhje me Ligjet e Kuvendit Popullor te Republikes se Shqipërise Nr. 7512 dt. 10.8.1991 për aksionimin e nismes private dhe mbrojtjen e prones private dhe te nismes se lire te veprimtarise private te pa m mvarur dhe privatizimit si dhe ne baze te Ligjit 7638 dt. 19.11.1993 për shoqeriste tregetare.

Shoqerija vepron si person juridik qe nga dita e regjistrimit te saje ne Gjykaten e Rrethit Tirane ndersa e ushtron aktivitetin ekonomik me marjen e lejes se ushtrimit te profesionit nga seksioni i finances Bashkis Qytetit.

**N E N I 7**

Shoqerija "GJERGJI" vepron nen regjimin e prones private dhe merr përsipër vete te drejta dhe detyrime

Ajo përgjigjet vetem për detyrimet e saje kontraktore e jashtekontraktore, brenda kapitalit te saje dhe prones se fituar

**N E N I 8**

Shoqerija eshte e krijuar dhe eshte prone e Z. PJETER PRELA Vendimet e mara prej tij dhe ne zbatim te ligjeve ne fuqi e sipas ketij statuti jane te detyrueshme për te gjithe te punesuarit ne kete shoqeri.

**N E N I 9**

Pronari i shoqeris "GJERGJI" qe eshte dhe administrator i saje ,sipas nevojave qe paraqiten për zhvillimin e veprimtarise, ekonomike e financjare te shoqerise, emeron administrator si dhe puneson punetoret e aktiviteve te ndryshme qe zhvillon, përmëndur ne nenin 4 te ketij statuti.

**N E N I 10**

Administratori i shoqeris dhe me autorizim administratoret e emeruar prej tij jane te veshura me te gjitha fuqite për drejtimin e zakoneshem dhe te jashtezakoneshem te shoqerise, pa asnje lloj përjashtimi dhe kane mundesi te kryejne te gjitha aktet qe konsiderojen te nevojeshme për aritjen e qellimeve te shoqerise. Ato kane de drejte midis te tjerash te blejne dhe te shkembejne pasuri, qe lidhen me shoqeri te tjera te krijuara, ose qe do te ngrihen ne vendin tone, qofshin edhe te hueja, duke siguruar pjesemarjen për qellimin e veprimtarise përmëndur ne nenin 4 te ketij statuti dhe te kryejne çdo lloj veprimi prane te gjitha zyrave shteterore dhe private, prane institucioneve bankare dhe financjare te gjitha veprimet qe kane te bejne me garancite; çeljen e kredive dhe veprimet hipotekorete çdo lloj.

Ne kete rast administratoret e ngarkuar kane për detyre te njoftojne e ti japin llogari administratorit te shoqerise.

**N E N I 11**

Administratori i shoqerise cakton administrator, te cileve ne aktin e emerimit i përcakton detyrat dhe pagen, po keshtu edhe për punetoret e punesuar, shoqerija merr përsipër te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit e te sigurimeve shoqerore për to, ne forma

stimuluese shpërblimi për punen e kryer,ndersa te punesuarit jane te detyruar te pranojne statutin e shoqerise.

N E N I 12

Administratoret nuk mund te marin cilesite e ortakut te shoqerise,por edhe te ushtrojne nje aktivitet konkurues te çfardollojt, për llogarit e tyre ose te treteve,përveç,atyre te autorizuar nga administratori i shoqerise.Për çdo shkelje ne kete drejtim administratori largohet nga shoqerija dhe përgjigjet për demet e shkaktuara.

N E N I 13

Shpenzimet e nevojeshme te kryera për mbajtejne administratoreve përballohen nga shoqerija.

PERFAQESIMI I SHOQERISE

N E N I 14

Përfaqesimi i shoqerise i përket administratorit te saje dhe administratoreve te caktuar prej tij.Administratoret zbatojne te gjitha vendimet e administratorit;ne kuadrin e te drejtave dhe detyrimeve dhene atyre,ne aktin e emerimit ose ne proçes verbal te veçante. Administratori dhe administratoret kane te drejte te përfaqesojne shoqerine ne organet gjyqesore te gjykimit, te emerojne e te pushojne avokat për çeshtjet ne gjykim.

N E N I 15

Veprimet ekonomike financjare te shoqerise mbyllen ne 31 Dhjetor te çdo viti,përveç urdherave te veçanta te administratorit te shoqerise.Ne fund te çdo periudhe ushtrimore administratoret nxjerin bilancin kontabel te shoqerise me rezultatet ekonomike fitime-humbje bazuar ne rregullat e ligjes te mbajtjes se kontabilitetit, qe kerkohen për njesite private dhe nga organet financjare përkatese.

Bilanci kontabel miratohet nga administratori i shoqerise.

N E N I 16

Te ardhurat neto pas veçimit te fondeve te akumulimit dhe pageses de detyrimeve fiskale,i mbesin ne perdorim administratorit te shoqerise.Eshte e drejta e tij te vendose për krijimin e fondeve nga e ardhura neto e krijuar si dhe për përdorimin e tyre.

N E N I 17

SHPERNDARJA E SHOQERISE

Shpërbërja e shoqerise mund te vije ne çdo kohe dhe për çfardo lloj shkaku.Administratori i shoqerise vendos mbi menyrat e likuidimit dhe cakton nje ose me shume likuidatore duke i u përcaktuar detyrat.Administratoret jane përgjegjes për ruajtjen e pasurise

...rore, përderisa t'ju dorezohet personave përkates fizike e juridike ...e likuiduar ne radhe te pare detyrimet ndaj personave te trete qe ...a shoqerija

NENI 18

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Përsa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet çdo ligji te veçante përkates te legjislacionit te shoqerise dhe veçanerisht Ligjit 7512 dt. 10.8.1991 si dhe plotesimeve qe do ti behen statuti nga administratori i shoqerise.

NENI 19

Ky statut përpilphet ne tre kopje për t'ju shperndare organeve kopetente dhe nje kopje mbetet si pjese e dokumentacionit për formimin e shoqeris private.

ORGANI I VETEM

PJETER PRELA

REPUBLIKA SHQIPERISE

GJYKATA RRETHIT

NOTERIA

Nr. 8214 Kolek.

Nr. 2952 Rep.

VERTETIM

Sot me date 18.7.1994(Nentedhjete e kater) para meje Andon Pano Notere ne qytetin e Tiranes u paraqit z. Pjeter Prela për identitetin e te cilit u sigurova nga leter njoftimi përkatese madhor dhe me zotesi te plote juridike për te vepruar i cili deklaroi se kete statut e ka bere jashte kesaj zyre dhe me vullnetin e tij, te cilin e firmos para meje dhe une noterja e firmos ate.

NOTERE

Andon Pano

PULLE TAKSE

AKT THEMELIMI

Une qi quajturi PJETËR PRELA,i biri i Gjergjit dhe Dielles,dtl. 1958 banues ne Lagjen Beslidhja Lezhe vendosa themelimin e shoqeris tregetare"GJEGJI" me përgjegjesi te kufizuar "Ortak i vetem" për te zhvilluar aktivitetin privat ne Republiken e Shqipërise

NENI 1

Selia e Shoqerise do te jete ne Lezhe Lagja Beszlidhja

NENI 2

Kapitali i shoqerise do te jete 100.000 leke dhe i përket ortakut te vetem.

NENI 3

Kohezgjatja e shoqerise eshte mbi 10 vjet

NENI 4

Objekti i veprimtarise shoqerise do te jete ne fushen:

Ndertime civile deri 5 kate,punime dheu,murature beto,beton arme e zakoneshme,punime shembjesh,ndertime civile,industriale,turistike, bujqesore e kompletimet me instalimet e nevojeshme për to,si dhe punime restaurimi.

Tregetim te materjaleve te para,materiale e paisje,makineri te llojeve te ndryshme përfshi dhe mjete transporti si dhe pjese kembimi për to me shumice e pakice,import eksport.

NENI 5

MËNYRA E ADMINISTRIMIT

Organi vendimor i shoqerise eshte ortaku i vetem

Ortaku i vetem ka te drejte te caktoj nje administrator qe do te përfaqesoje shoqerine ne maredhenje me te tretet,por ky përfaqesim do te behet brenda kopetencave qe ortaku i vetem do t'i caktoje administratorit.Për veprimet e kryera jashte objektit te veprimtaris shoqerise,nga ortaku i vetem, si dhe për veprimet e kryera nga ky i fundit ne kundershtim me statutitn dhe me Ligjen Shqipëtare qe eshte ne fuqi do te përgjigjet administratori moralisht ashtu dhe materjali

NENI 6

Maredhenjet e administratorit apo ortakut te vetem me te punesuarit do te rregullohen ndermjet kontrates se punes.

NENI 7

Te gjitha mosmareveshjet qe do te lindin gjate veprimtaris se shoqerise do te zgjidhen ne rruge gjyqesore dhe gjykate kopetente eshte gjykata e Rrethit Lezhe.

## N E N I 8

## DISPOZITAT E FUNDIT

Ketij akt themelimi do ti bashkangjitet statuti i shoqerise ne te cilin jane përcaktuar qarte pikat kryesore ne te cilat do te mbeshtetet shoqerija ne ushtrimin e aktivitetit te saje.

ORTAKU I VETEM
PJETER PRELA

REPUBLIKA SHQIPERISE
GJYKATA RRETHIT
N O T E R I A
Nr. 1205 Kolek.
Nr. 2753 Rep.

## V E R T E T I M

Sot me date 18.7.1994 (Nendedhjete e kater) para meje Andon Pano Notere ne qytetin e Tiranes u paraqit Z. Pjeter Prela për identitetin e te cilit u sigurova nga leter njoftimi personal, madhor dhe me zotesi te plote juridike për te vepruar i cili deklaroj se kete akt themelimi e ka bere jashte kesaj zyre dhe me vullnetin e tij, para meje e nenshkruan dhe une noterja e firmos.

N O T E R E
Andon Pano

PULLE TAKSE
NOTERIA TIRANË